

## ***BULETINI INFORMATIV I IGJK-se***

*Nëntor 2002*

### **Hyrje**

Instituti Gjyqësor të Kosovës i është dhënë mandati që të trajnoj gjyqtaret e Kosovës dhe prokurorët. Ne Gusht 1999 Seksioni i Trajnimit Gjyqësor i Departamentit të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës i OSBE-së filloi t'ia prezentojë Programin e tij të Edukimit të Vazhdueshëm Ligjor (PEVL) gjyqtarëve në Kosovë. PEVL i IGJK-së përfshin aktivitete edukative në Kosovë dhe jashtë. Përgjatë vitit 2002, IGJK ka menduar që t'i adresohet nevojave të gjyqtarëve që punojnë në Kosovë nëpërmjet PEVL.

Në një përpjekje për të informuar më shumë gjyqtarët e Kosovës për aktivitetet trajnuese të ofruara nga IGJK, u formua ky buletin. Ai do t'i dergohet gjyqtarëve dhe prokurorëve kudo në Kosovë..

### **Projekt aktivitetet për Nëntor**

A Trajnim i shkathtësive profesionale

B Trajnim i shkathtësive praktike

C Seminar mbi të drejtën administrative

D Seminar mbi aplikimin e konventave dhe standardeve ndërkombëtare për gjykatat për kundërvajtje

E Diskutim në tryezë të rrumbullakët mbi bashkëpunimin në mes policisë, prokurorisë dhe gjyqësisë

F Trajnim për provimin e judikaturës

G Vizitë studimore në Gjermani

H Vizitë studimore në Strasbourg

### **Trajnim i shkathtësive profesionale 13-15 Nëntor dhe 18-20 Nëntor 2002**

A. IGJK, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare Ligjore për Zhvillim (ONLZ), përpara INLZ, ka organizuar një seri të kurseve trajnuese për shkathtësitë profesionale. Kjo seri



e trajnimeve do të përqëndrohet në zhvillimin e shkathtësive esenciale të nevojshme në punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

- Dita e parë e trajnimit do të ketë diskutime në hyrjen në rolin e gjykatave në një demokraci moderne, rolin e gjyqtarit në një demokraci moderne, koncepti i “gjykimit të drejtë”, shkathtësitë gjyqësore dhe prokuroriale dhe aspektet praktike të procesit para-gjykimor.
- Dita e dytë do të mbulojë një hyrje në menaxhimin e rrjedhës së rastit, standardet ndërkombëtare dhe praktika lokale, manovrimi me prova, relevanca e prova dhe inxhizimi i provave.
- Dita e tretë mbulon marrjen në pyetje të dëshmitarëve, relevancën e deklaratave të dëshmitarëve, inxhizimin e deklaratave të dëshmitarëve dhe menaxhimi i gjykatës. Ky trajnim tre-ditorë do të mbahet nga 13-15 Nëntori 2002 për gjyqtarë penalista dhe prokurorë dhe prej 18-20 Nëntorit 2002 gjithashtu për gjyqtarë penalistë dhe prokurorë. Thirrjet do të dërgohen, për të njoftuar pjesëmarrësit se për cilin sesion do të thirren. Sesioni i mëvonshëm do të mbahet për gjyqtarë të së drejtës civile dhe për gjyqtarë për kundërvajtje.

### **Trajnim i shkathtësive praktike 04-13 November 2002**

**B.** IGJK, CDRC dhe USDoJ janë duke mbajtur një seri të sesioneve trajnuese të cilat i adresohen shkathtësive praktike. Sesioni i ardhshëm do të fillon më 04 Nëntor dhe do të vazhdojë deri më 13 Nëntor, dhe do të mbahet në Brezovicë. Përsëri do të marrin pjesë prokurorë publik dhe avokatë. Raste studimi janë përgatitur dhe utilizuar në këtë ngjarje interaktive..

### **Seminar mbi të drejtën administrative 21 Nëntor**

**C.** Seminari mbi të drejtën administrative do të mbahet nga IGJK. Gjatë trajnimit, një analizë krahasimore e procedurës administrative dhe procedurës civile do të mbahet. Tre ekspertë vendorë do të sigurojnë prezentime mbi të drejtën administrative. Kjo ngjarje është planifikuar për 21 Nëntor 2002.

### **Seminar mbi aplikimin e konventave dhe standardeve ndërkombëtare për gjykata të kundërvajtjes 25-26 Nëntor 2002**

**D.** IGJK është duke organizuar një trajnim mbi konventat dhe standardet ndërkombëtare për gjyqtarë që punojnë në gjykatat për kundërvajtje. Ekspertë ndërkombëtarë janë identifikuar me ndihmën e Këshillit të Europës për të dhënë prezentime. Kjo ngjarje është e planifikuar për 25 dh 26 Nëntor 2002. Dy ngjarje një-ditore, do t'i japin rastin të gjithë gjyqtarëve për kundërvajtje që të marrin pjesë në njerën prej ditëve.



## **Trajnim për provimin e judikaturës 04 October-23 November**

E. Oficerët e trajnimit gjyqësor të IGJK-së janë duke siguruar mbështetje në progres për Seksionit për Mbështetje të Bashkësisë Ligjore të OSBE-së, duke dhënë ligjërata në trajnimin për kursin e provimit të judikaturës i cili mbahet çdo të Premte dhe të Shtunë në IGJK. Klasa e katërt për 2002 filloi më 4 Tetor dhe do të mbyllet më 23 Nëntor..

### **Diskutim në tryezë të rrumbullakët mbi bashkëpunimin nëmes, policisë, prokurorisë dhe gjyqësisë 27 Nëntor 2002**

F. Në mënyrë që të zmadhojë ndihmën e bashkëpunimit nëmes anëtarëve të gjyqësisë, prokurorisë dhe policisë, IGJK-ja është duke organizuar një diskutim në tryezë të rrumbullakët. Ky sesion do të mbulojë bashkëpunimin në fushën e narkotikëve dhe Rregullores së UNMIK-ut 2002/7 mbi përdorimin e shënimeve të shkruara të intervistave të kryera nga ana e autoritetit për zbatimin e ligjit në procedurë penale. Një numër prej 18 pjesëmarrësve janë thirrur, duke përfshirë gjyqtarët hetues, prokurorët publik dhe anëtarët e forcave të policisë. IGJK ka zgjedhur 6 gjyqtarë hetues dhe 6 prokurorë publik nga Gjykatat e Qarkut dhe Komunale/Zyrave të Prokurorisë. SHPK ka zgjedhur 6 oficerë të policisë për të marrur pjesë. Ky seminar është planifikuar për 27 Nëntor.

## **PROGRAMI I STUDIMIT JASHTË VENDIT**

### **Vizitë studimore në Gjermani Datae: 10-16 Nëntor 2002**

IGJK ka kryer përgatitje për të dërguar një grup prej (10) gjyqtarëve dhe prokurorëve për një vizitë studimore në Gjermani. Pjesëmarrësit do të kalojnë kohën në Gjykatat Gjermane në Berlin, Erfurt, Thuringia dhe Leipzig. Ata do të vështrojnë sistemin gjyqësor dhe do të kenë rastin që të ndërveprojnë me gjyqtarët Gjerman në këto qytete. Vizita studimore në Gjermani është planifikuar për periudhën prej 10 deri 16 Nëntor 2002.

### **Vizitë studimore për Strasbourg Data: 26-27 Nëntor 2002**

H. IGJK dhe Këshilli i Europës janë duke organizuar një vizitë studimore dyditore në Strasbourg, Francë për 4 gjyqtarë nga Kosova. Ata do të vizitojnë Gjykatën Europiane dhe Këshillin e Europës. Kjo vizitë studimore do t'i japë gjasën pjesëmarrësve për të mësuar më shumë për funksionin e Gjykatës Europiane dhe si aplikohen Konventat ndërkombëtare.

